



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.03.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të punës së komisionit.
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 11.02.2019 dhe 12.02.2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar””.
4. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Elona Hoxha, Spartak Braho, Milva Ekonomi dhe Paulin Sterkaj.

Mungojnë:

Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Pjerin Ndreu, Elena Xhina, Luan Duzha

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm

Alma Mehmeti - Përfaqësuese e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme.

Ela Zaimi - Përfaqësuese nga Instituti i Policisë Shkencore

Orest Afejzulli - Përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore

Dalimir Kurti - Specialist nga Ministria e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Falënderoj kolegët për prezencën dhe për faktin që u detyruam ta zhvillojmë sot mbledhjen, meqenëse seanca e parlamentit do të zhvillohet të martën dhe për këtë shkak do të duhet që axhenda të përmbyllet 48 orë para rendit të ditës që shqyrton Kuvendi i Shqipërisë.

Çështja e parë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje është miratimi i kalendarit 3-javor të punës së komisionit. Besoj se nuk keni vërejtje për këtë, sepse kalendari u miratua edhe në seancën e fundit parlamentare.

Çështja e dytë në rendin e ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 11.02.2019 dhe 12.02.2019. Ka vërejtje apo kundërshtime? Nuk ka.

Faleminderit!

Sot kemi shqyrtimin e dy projektligjeve:

- “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar””.

- “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Për të prezantuar projektligjin e parë kemi ftuar përfaqësuesit nga Ministria e Brendshme dhe më konkretisht, zëvendësministren e Brendshme, zonjën Rovenë Voda, të shoqëruar nga zonja Alma Mehmeti, po ashtu, përfaqësuese nga Ministria e Brendshme, të cilat i falënderoj për pjesëmarrjen.

Fjalën e ka zonja Rovenë Voda për të bërë një prezantim të projektligjit, i cili është i njohur për publikun dhe për komisionin.

Rovenë Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëdita, të nderuar deputetë!

Më vjen mirë që si zëvendësministre e Brendshme, që ka si fushë përgjegjësie Departamentin e Gjendjes Civile, ku pas diskutimit që patëm (mua më pëlqen të kthehem pak prapa në kohë), kur ishim në komisionin tuaj të nderuar për të prezantuar projektligjin e

propozuar nga Ministria e Brendshme “Për një ndryshim në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, një nga rekomandimet tuaja, zonja kryetare, por edhe e të gjithë deputetëve të nderuar që janë këtu, ishte pikërisht fakti që për të garantuar një proces zgjedhor për të gjithë qytetarët e RSH-së, të drejtën e votës dhe për të shmangur flukset e mëdha në zyrat e shërbimit të ALEAT-it, duke pasur parasysh që ka edhe njerëz të moshuar, ka edhe nga ata që janë në punë, pra për të krijuar një lloj lehtësie për pajisjen me to, një nga propozimet që u bë edhe nga komisioni ishte që të shikohej mundësia e shtyrjes së afatit të përdorimit të letërnjoftimit elektronik. Kështu, jemi sot para komisionit për të paraqitur pikërisht projektligjin për çështjen që ju përmendët, pra “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar””, i cili është një ligj i shkurtër me vetëm 2 nene, ku kemi propozuar që vlefshmëria e afatit të kartave të identitetit të lëshuara për herë të parë në datën 9.2.2009, të bëhet deri më 31.12.2019.

Unë e përmend edhe një herë se nevoja për miratimin e këtij projektligji lidhet me realizimin e një procesi zgjedhor sipas standardeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të RSH-së. Bazuar në këtë kod, neni 105, “Paraqitja e zgjedhësit në qendrën e votimit”, shtetasi duhet të paraqitet për të votuar me letërnjoftimin elektronik ose me pasaportën biometrike, si dhe të përfitimit të shërbimeve publike, por jo vetëm, por të kushtëzuara me pajisjen e një letërnjoftimi elektronik të vlefshëm.

Kështu, siç e përmenda, duke u nisur nga fakti që kemi pasur në fakt flukse të mëdha qytetarësh dhe dyndje të tyre në zyrat e ALEAT-it për t’u pajisur me letërnjoftime dhe për të mundësuar të drejtën e votës për të gjithë shtetasit shqiptarë (të mos harrojmë që kemi edhe kategori vulnerabël, pra kemi edhe njerëz në nevojë, të cilët në këtë periudhë që ka mbetur, mund edhe të mos munden të paraqiten pranë zyrave të ALEAT-it për t’u pajisur me letërnjoftime elektronike, u bë i mundur ky propozim. Në vija të përgjithshme, ky ishte propozimi që po i paraqesim sot Kuvendit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Voda!

Tani do të na thotë 2 fjalë në lidhje me këtë projektligj relatori i komisionit, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja zëvendësministre,

Ju dëgjova me vëmendje. Ju ishit shumë e qartë. Natyrisht, ka qenë një propozim i anëtarëve të Komisionit të Sigurisë. Unë do të bëj një përmbledhje të shkurtër të këtij projektligji, i cili do t'u krijojë mundësi të gjithë shtetasve shqiptarë të votojnë në zgjedhjet e muajit qershor.

Ndryshimet në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 8668, datë 23. 10. 2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, i ndryshuar”, vijjnë si domosdoshmëri për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, të cilëve u skadon afati i vlefshmërisë së kartës ID përgjatë vitit 2019.

Pavarësisht njoftimeve të shumta, aplikimi për rinovimin e kartave ka sjellë fluks aplikimesh nga shtetasit shqiptarë pranë zyrave në të gjitha bashkitë. Sipas të dhënave statistikore të marra nga shoqëria koncesionare “ALEAT”, pothuajse 1,4 milionë shtetasve shqiptarë u përfundon afati i vlefshmërisë së kartës ID në vitin 2019 dhe afati kohor në dispozicion për ripajisjen me letërnjoftim të ri elektronik është mjaft i kufizuar.

Skadimi i afatit të ID-së ndodh në shumë raste edhe me skadimin e afatit të pasaportës biometrike. Letërnjoftimi elektronik shërben si dokument identiteti bazë për identifikimin e shtetasve shqiptarë, jep mundësi për të votuar, siguron marrjen e shërbimeve të ndryshme publike, por jo vetëm, si dhe shërben si dokument udhëtimi, ndër dokumentet e tjera të vlefshme të udhëtimit. Për t'u mundësuar të gjithë shtetasve shqiptarë, të cilëve u përfundon afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik, të drejtën kushtetuese të votës, si dhe marrjen e një numri të madh shërbimesh që kushtëzohen nga ky dokument zyrtar, me anë të këtij ndryshimi propozohet që afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve që janë lëshuar nga data 09.02.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2019.

Mendoj se është një formalitet nga Komisioni i Sigurisë, ndaj u propozoj kolegëve që ta votojmë këtë projektligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Ndryshimi i propozuar është i qartë dhe i thjeshtë për nga përmbajtja. Ndërkohë, besoj se për komisionin, por edhe për publikun do të na interesonte një informacion i shkurtër për masat që ka marrë institucioni që ju përfaqësoni për hapjen e pikave të aplikimit. Pra, kemi parë që, veçanërisht në Tiranë, ka pasur një kujdes në hapjen e zyrave të përbashkëta me shoqërinë e përgatitjes së letërnjoftimeve “ALEAT”. Si vijon ky proces në të gjithë vendit? A

do të ketë radhë të gjata deri në fund të vitit, që është edhe afati maksimal për rinovimin e kartave të identitetit? Besoj se kjo ka interes për të kuptuar se çfarë nënkupton shtyrja e këtij afati.

Rovena Voda – Faleminderit, zonja kryetare!

Ministria e Brendshme së bashku me shoqërinë “ALEAT”, që bën prodhimin e kartës të identitetit dhe pasaportës biometrike, kanë pasur një plan veprimi të përbashkët të hartuar që në muajin shtator. Bashkëpunimi me njësitë vendore ka qenë shumë i rëndësishëm për implementimin e këtij plani. Në fakt, kemi gjetur një bashkëpunim shumë të mirë me bashkinë e Tiranës. Ministria e Brendshme nuk do të mund të ishte e suksesshme në hapjen e zyrave të aplikimit nëse do të ishte e vetme. Më vjen mirë të them që sot pothuajse në të gjitha njësitë e bashkisë Tiranë ne kemi zyra shtesë aplikimi për qytetarët. Është filluar me njësitë 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9. Pra, ka pasur seriozitet në përmbushjen e premtimit që do të krijohet mundësia për hapjen e zyrave të reja. Sot situata paraqitet shumë më e qetë sesa me fillimin e flukseve, kur ende nuk kishin hapur zyra të reja aplikimi dhe nuk kishte punonjës shtesë. Kompania “Aleat” ka marrë të gjitha masat për të punësuar edhe punonjës shtesë, por shpeshherë zyrat janë mbajtur hapur edhe ditën e shtunë, që është ditë pushimi.

Me të njëjtin ritëm po punohet edhe në qytetet e tjera të mëdha, nuk i kam statistikën, më vjen keq, por edhe në qytetin e Durrësit janë hapur zyra të reja, edhe në Vlorë janë marrë masa për hapjen e tyre, edhe në Fier. Ne jemi në diskutim, kjo edhe për transparencë me komisionin për të mundësuar hapjen e zyrave të reja të aplikimit, të cilat do të shtrihen jo vetëm në të gjitha qytetet e mëdha, por mundësisht brenda një periudhe kohore 2-3 mujore edhe në njësi administrative të largëta, ku qytetarët shpeshherë e kanë të vështirë të lëvizin. Është menduar që kjo të bëhet pak më vonë, pra që të largohet fluksi i madh nga qendrat e mëdha urbane dhe më pas të procedohet me njësitë që janë më të vogla, të cilat nga një analizë dhe studim që ka bërë kompania “Aleat”, shprehen se për shkak të numrit të vogël që kanë banorët në këto zona, për 3-4 ditë apo një javë mbyllet procesi i aplikimit dhe nuk ka problem. Këtë po tentojmë tani që të mund të shkojmë me zyra në njësitë administrative të largëta. Kjo edhe për një fakt tjetër, qytetarët, pavarësisht se ne po e shtyjmë këtë afat për t’u dhënë siguri, mundësi edhe kategorive vulnerabël, që ndoshta nuk do të mundin deri në qershor të pajisen me karta identiteti, të mos harrojmë se në 6 - mujin e dytë të vitit 2019 do të kemi fluksin tjetër që është ai i skadimit të

pasaportave biometrike, prandaj zgjerimi me zyrat e reja dhe poste të reja aplikimi, është prioritet. Kjo do të bëhet brenda vitit 2019, sepse nuk kemi vetëm ID-të, por edhe pasaportat biometrike. Sfidë për ne mbetet hapja e zyrave në njësitë e largëta administrative që edhe në ato njësi të largëta qytetarët të kenë akses

Ermonela Felaj - Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje nga kolegët lidhur me sqarimet e bëra?

Milva Ekonomi- Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj zëvendësministren për shpjegimin e plotë. Kisha një pyetje për zonat e largëta dhe ju morët kohën dhe na e sqaruat, sepse nëpër qendrat e mëdha përveç fluksit të madh që ka nga banorët, aksesimi është më i lehtë, por në këto zona aksesimi është më i vështirë.

Një tjetër gjë e rëndësishme që doja të shtoja është se shtyrja e afatit u shërben të gjithëve, cilësisë më të mirë të punës dhe mospengimit të proceseve që lidhen me numrin individual. Besoj se për ne është një akt i mirë ligjor, ky që po marrim përsipër.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj - Meqenëse teknologjia vjen duke u përsosur dhe çmimi duhet të vijë duke u ulur, jo duke u rritur. Pse duhet të rritet çmimi i kartave të identitetit dhe i pasaportës biometrike sa herë që ato ndërrohen? Kjo është në kurriz të shqiptarëve. Kam bindjen se ka familjarë që nuk kanë mundësi për të përballuar pagesën. Ky është shqetësim dhe jo afati.

Ermonela Felaj – Po, zonja Voda

Rovena Voda – Zoti Sterkaj, është një konstatim shumë i drejtë. Si zëvendësministre kam dy vjet në këtë ministri, historia në këtë ministri ka filluar në vitin 2017, të njëjtën pyetje kam edhe unë, pyetja të lind natyrshëm. Është e vërtetë që karta do të ketë disa elemente sigurie shtesë më shumë sesa karta aktuale. Ka pasur edhe ide që ajo kartë mund të ketë disa funksione, mund të lexohet shumë mirë, ajo kartë mund të përdoret edhe si kartë studenti, si kartë shëndeti. Ka pasur disa ide, pasi janë rritur elementet e sigurisë, por nga Drejtoria Juridike e Ministrisë së Brendshme jam vënë në dijeni se rritja e çmimit është parashikuar në një ndryshim ligjor, që është bërë në ligjin “Për koncesionarin” në vitin 2013. Është zgjidhur afati i kontratës dhe është prekur edhe pjesa e çmimit, është lejuar të ketë edhe një rritje të çmimit. Fatkeqësisht, ka pasur një ndryshim ligjor në vitin 2013.

Ermonela Felaj – Po, është e vërtetë, në fakt, sepse ne kemi diskutuar për këtë gjë edhe në mbledhjen e grupit parlamentar.

Çmimi për pajisjen me ID ose me pasaportë biometrike është i fiksuar në marrëveshjen koncesionare, një marrëveshje e miratuar në parlament. Megjithatë sugjerimi gjithmonë do të jetë për institucionin qendror që kjo kohë shtesë të mos përdoret vetëm për të lejuar mundësi më të mira për aplikim dhe akses më të mirë të njerëzve, por edhe për të parë këtë pjesën e ndihmës që ne duhet të bëjmë ndaj kategorive të veçanta, të cilat me gjasë do të kenë vështirësi për ta përballur çmimin e pajisjes me kartë identiteti apo edhe me pasaportë biometrike.

Sidoqoftë, besojmë se kjo do të ngelet në planet tuaja të punës për muajt në vijim.

Atëherë, duke gjykuar se nuk ka më pyetje për këtë temë, do t'ju ftoja të kalonim në miratimin në parim të projektligjit të propozuar.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, hyrja në fuqi e projektligjit.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord me shtesën e propozuar në ligjin nr.89/52, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, të ndryshuar”?

Faleminderit!

Na duhet ta bëjmë procedurën sepse fiksohet në procesverbal, kështu që nëse nuk e bëjmë, është e pavlefshme.

Faleminderit, zonja zëvendësministre dhe zonja tjetër për prezantimin dhe ndihmën në komision!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 1.03.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Elona Hoxha, Spartak Braho, Milva Ekonomi dhe Paulin Sterkaj.

Mungojnë:

Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Pjerin Ndreu, Elena Xhina, Luan Duzha

Të ftuar:

Besfort Lamallari – Zëvendësministër i Brendshëm

Ela Zaimi - Përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore

Orest Afejzolli- Përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore

Dalimir Kurti -Specialist në Ministrinë e Brendshme

Ermonela Felaj - Kalojmë në shqyrtimin e marrëveshjes tjetër “Ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet palëve të konventës së bashkëpunimit policor”

Projekti është propozuar, është miratuar nga KM-ja dhe i propozohet parlamentit për miratim.

Kjo marrëveshje ka të bëjë me shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, atyre daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve.

Për të na thënë diçka më tepër rreth këtij projektligji dhe marrëveshjes në fjalë, ne kemi të ftuar sot zotin Besfort Llamallari, zëvendësministër i Brendshëm dhe zotërinj të tjerë të Ministrisë së Brendshme; zotin Orest Afezulli, përfaqësues i Institutit të Policisë Shkencore; zotin Dalimir Kurti, specialist në Ministrinë e Brendshme dhe zonja Ela Zaimi, përfaqësuese nga Institutit të Policisë Shkencore.

Faleminderit për prezencën!

Me zotin Lamallari kemi qenë edhe herë të tjera në komision, por përfaqësuesit e Institutit të Policisë Shkencore nuk i kemi pasur në ndonjëherë në komision, prandaj besoj se është një rast i mirë për të diskutuar së bashku.

Urdhëroni, zoti Lamallari!

Besfort Lamallari – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Duke vlerësuar këtë komision të nderuar, zgjedha që të shoqërohem, përveç përfaqësuesve të ministrisë, edhe nga përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore, të cilët e kanë ndjekur, në fakt, këtë marrëveshje hap pas hapi. U bënë gati dy vjet që ne kemi negociuar këtë marrëveshje, ashtu si edhe vendet e tjera.

Marrëveshja në thelb është përafrim ose replikim i marrëveshjes së traktatit të Prymit, e aplikuar me shumë sukses në nivel europian, ku në thelb synohet shkëmbimi i automatizuar online i të dhënave daktiloskopike, pra gjurmëve të gishtave, profileve të ADN-së dhe të dhënave të automjeteve.

Shqipëria e nënshkroi bashkë me vendet e tjera, përjashtoi dy nga vendet anëtare të Konventës të Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, të cilat për arsye politike dhe teknike nuk arritën ta nënshkruajnë këtë marrëveshje.

Gjithsesi, Shqipëria me 13 shtator 2018 e nënshkroi marrëveshjen dhe bashkë me të u nënshkrua edhe një memorandum mirëkuptimi nga gjithë ministrat nënshkrues, i cili shikonte më tej se sa vetë marrëveshja, pra shikonte edhe zbatimin e saj, pasi përmes këtij memorandum u bëhej thirrje të gjithë donatorëve të mundshëm, organizatave ndërkombëtare që të financonin zbatimin e marrëveshjes, e cila bëhet e mundur përmes aksesit në rrjetin e enkriptuar Testa, pronë e Komisionit Europian dhe përveç të dhënave që mbulohen nga kjo marrëveshje, përmes këtij rrjeti përcillen në mënyrë të sigurtë edhe të dhëna të tjera, që lidhen me fushën e doganave, tatimeve, financave e të tjera. Njëkohësisht, Shqipëria negocioi edhe me Austrinë, një nga vendet anëtare të Bashkimit Europian, pesë nga të konventës janë të Bashkimit Europian, dhe siguroi mbështetjen e saj, për të qenë mentorja e Shqipërisë si në aspektin politik, në raport me Komisionin Europian, ashtu edhe në aspektin e mbështetjes financiare. Ata dërguan menjëherë një mision faktmbledhës në Shqipëri, për të vlerësuar gjendjen reale të data bazave të sistemeve.

Nga takimi që kam pasur, kanë shprehur vlerësime për sa i përket data bazave që zotërohen nga Instituti i Policisë Shkencore, që janë AFIS-i kriminal dhe CODIS, që është për profilet e ADN-së. Sigurisht, po punohet edhe për pjesën e targave dhe e të dhënave të automjeteve. Gjithsesi, që të mundësohet zbatimi në praktikë i kësaj marrëveshjeje, për të gjitha vendet nënshkruese kërkohet financim dhe akses në sistemin TESA, për të cilin është dhënë konsensusi politik nga Komisioni Europian.

Aktualisht, në bashkëpunim me AKSH-in, ne po mundohemi të identifikojmë të gjithë aktorët, agjencitë, institucionet në vend, të cilët do të kishin interes për shkëmbimin e sigurtë të të dhënave, si Pastrimi i Parave, Shërbimi Informativ i Shtetit, që mund ta shfrytëzojnë sistemin TESA për qëllimet e tyre të përditshme.

Së bashku me AKSH-in po punohet për identifikimin e gjithë këtyre aktorëve, e më pas do të identifikohen edhe kostot, të cilat duhet të ndahen mes agjencive që përfitojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Nga Komisioni Europian, në negociatat që kemi pasur, na janë referuar me shifra për vitin 2018. Shifrat ndryshojnë nga viti në vit, për vendet e ndryshme, të cilat paguajnë *fee*-në vjetore. Mendoj se po shkon mirë procesi i punës, pra përgatitja e zbatimit real praktik të kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Jemi të hapur për çdo pyetje.

Ermonela Felaj – Besoj se në lidhje me pyetje-diskutimet, do të kemi nevojë të shkëmbejmë mendime edhe me dy përfaqësuesit e Institutit të Policisë Shkencore. Për momentin, më duhet t'ia kaloj fjalën zonjës Gjebrea, e cila është relatore e këtij projekti.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare,

Faleminderit, zoti zëvendësministër,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Brendshme e të Policisë Shkencore,

Në fakt, ky është një projektligj i rëndësishëm në lidhje me forcimin e sigurisë nëpërmjet shkëmbimit automatik të të dhënave. Sigurisht, në radhë të parë duhet përgëzuar për këtë marrëveshje, e cila ndërkohë konsolidon edhe Shqipërinë, bashkë me të gjitha vendet që janë pjesë e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, që sikurse thashë, do të mundësojë bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar, kundër krimeve të rënda, krimeve ndërkufitare apo për luftën kundër terrorizmit.

Për të mos përsëritur ato çfarë tha dhe zëvendësministri, vlen të theksohet se ky projektligj do të bashkëpunojë edhe me institucionet e tjera. Në fakt, Ministria e Brendshme është porta hyrëse në këtë situatë, dhe patjetër është e nevojshme të analizohen të gjithë aktorët që do të jenë pjesë e këtyre shkëmbimeve. Përveç rëndësisë, duhet të kemi kujdes edhe në lidhje me mënyrën se si përdoren, mënyrën se si do të ruhen, por patjetër edhe për mënyrën se si Policia Shkencore do të forcojë kapacitetet e veta, pse jo dhe fakti i pasjes së një buxheti të alokuar për këtë.

Në fakt, ne e patëm zëvendësministrin në Komisionin e Politikës së Jashtme, dhe ndonjëherë tejkaluam kompetencat edhe bëmë pyetje teknike, të cilat ky komision mund t'i adresojë më mirë, arsye për të cilën kemi këtu edhe përfaqësuesit e Policisë Shkencore.

Ajo që u theksua, e që unë po i transmetoj, meqenëse po kalojnë te komisioni këtu, pra merakun se si do të bashkëpunohet me AKSH-in e me strukturat e tjera shtetërore, në lidhje me shkëmbimin e informacionit, të dhënat individuale e kështu me radhë.

E dyta ka të bëjë me faktin e një buxheti të alokuar, i cili, me sa kuptuam ne, kishte pasur diskutime me donatorët, por, nga ana tjetër, ishte e nevojshme që buxheti i shtetit, Ministria e Brendshme të kishte një fond të dedikuar në lidhje me këtë gjë. Patjetër, në këtë moment që jemi, merakun ynë ka të bëjë edhe me faktin se si mund të vazhdohet më tej dhe çfarë strategjie mund të

ketë në momentin që një vend tjetër do të kërkojë shkëmbim të dhënash të kësaj natyre. Gjithsesi, sikurse e thashë, e rëndësishme është që prevalon rëndësia që ka kjo gjë në luftën kundër krimit dhe nevoja për të bashkëpunuar më mirë me shtetet e tjera. Po ashtu u përmend edhe fakti pse Kosova nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje. Në fakt, ne e morëm përgjigjen nga zëvendësministri, ndaj unë thjesht po adresoj një mendim të Komisionit të Politikës së Jashtme. Kështu, vlen të theksoj se projektligji nuk synon përafrim të drejtpërdrejt me *acquis*-të e BE-së, por zbatimi i kuadrit Prum do të mundësojë që Shqipëria të avancojë dukshëm në zbatimin e kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Sikurse e thashë, ky projektligj është shumë i rëndësishëm, por do të ishte mirë që edhe zëvendësministri të na shpjegojë disa gjëra, të cilat ne ndoshta i kemi përmendur në Komisionin e Jashtëm, por dolën edhe si rezultat i pyetjeve apo sugjerimeve të kolegëve. Unë besoj se ne jemi të sigurt që kjo është një marrëveshje e konsoliduar, por, në radhë të parë, është një marrëveshje, që respekton të drejtat dhe liritë e njeriut.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Gjebrea!

Po e bëj unë pyetjen tuaj dhe pyetjen e zotit Sterkaj. Ne sot po krijojmë mundësinë që Shqipëria të aksesojë në të dhënat që kanë edhe 10 shtete të tjera për sa u përket ADN-së, gjurmëve daktiloskopike dhe ato që kanë lidhje me regjistrimin e automjeteve. Unë do të doja të pyesja një nga përfaqësuesit e Institutit të Policisë Shkencore: kur pritet që kjo marrëveshje të bëhet efektive? Pra, kur do të bëhet i mundur shkëmbimi real i këtyre të dhënave, meqenëse këtu u tha se duhet edhe një lloj kostoje?

Ju lutem, na bëni një shpjegim praktik të gjësë se çfarë ndodh aktualisht, sepse ne kemi të individualizuar ose kemi një sistem të gjurmëve kapilare të personave, që kanë kryer një vepër penale. Instituti është një hallkë shumë e dobishme në procesin e hetimit penal për shkak se merret me krahasimin e gjurmëve kapilare dhe mundësisë që i jep organizmit të hetimit për të identifikuar autorët e veprave penale. Sidoqoftë, në raport me këtë marrëveshjeje, neve do të na interesonte një shpjegim praktik, që të na tregojë se në çfarë nivelesh të tjera do të arrijë puna e institutit?

Orest Afejzulli – E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Unë jam shefi i Sektorit të Gjurmëve të Gishtave në Institutin e Policisë Shkencore, ku merremi me sistemin automatik të gjurmëve të gishtave dhe pëllëmbës së dorës, pra me sistemin AFIS. Kuptohet që çdo polici në botë ka sisteme të tilla, ku administrohen gjurmët e gishtave të personave të ndaluar, të arrestuar, emigrantëve ilegalë, të depërtuarve, si dhe gjurmët e punonjësve të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve ligjore. Ku konsiston pika më e rëndësishme e këtij shkëmbimi automatik?

Në radhë të parë, ky shkëmbim do të bëhet *online*, në kohë reale, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës, pa ndërhyrjen e specialistëve tanë apo specialistëve të shteteve të huaja. Kjo bëhet për arsye se sistemi ka në bazë disa formate të shkëmbimit të informacionit, ku për gjurmët e gishtave është formati AFIS, i cili konverton në mënyrë automatike të dhënat. Për shembull, *database* i gjurmëve të gishtave të sistemit AFIS të Austrisë do të futet direkt në sistemin tonë automatik të Policisë së Shtetit. Në këtë kohë bëhet krahasimi automatik, pa ndikimin e operatorëve, i këtij informacioni dhe të dhënat jepen *online* në ekranin nga posti i punës, ku është nisur ky informacion. E rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave është fakti që informacioni del i inkriptuar, nuk ka të dhëna alfanumerike të personit, por del vetëm imazhi. Për shembull, në rast se do të ketë një vrasje dhe kemi siguruar një gjurmë gishti të vlefshëm për indentifikim apo pëllëmb, direkt nga sistemi AFIS, duke e konvertuar në formatin “Mist”, mund ta çojmë në dhjetë *database*-t e shteteve pjesëmarrëse.

Për momentin në *database*-n tonë kemi 350 mijë kartela me gjurmë gishtash, në Austri kemi 1 milion kartela, në Slloveni janë 800 mijë kartela dhe në Serbi janë rreth 1 milion kartela. Pra në këto dhjetë *database* kemi mundësi të kemi që ta konsultojmë këtë informacion, nëse ky person që ka lënë këto gjurmë gishtash në këtë ngjarje në Shqipëri është i indeksopuar në një shtet tjetër, pasi kemi bërë krahasimin në Shqipëri.

Ne marrim informacionin që sistemi e gjeneron në mënyrë automatike, pra jepet një listë kandidatësh dhe çdo ekspert që e nis këtë informacion e krahason.

Në bazë të marrëveshjes, në rast se bindemi që kemi informacion, atëherë behet kontrolli i dytë dhe i tretë, që përfundimisht është një identifikim dhe njoftohet që ky informacion i kriptuar të çkriptohet, në mënyrë që Policia e Shtetit të dijë që ky person ka këtë emër. Në rast se nga ana e prokurorisë çështja do të ndiqet penalisht, atëherë është procedura që parashikon letërporosinë nga Ministria e Drejtësisë për shtetin përkatës që sigurohet prova.

Të flasim për hetimin policor, në momentin që kemi një ngjarje të rëndësishme ne kemi mundësi të marrim informacion *online* brenda 5 minutash, që kjo gjurmë i përket këtij personi që është në një nga shtet anëtare të kësaj konvente, por dhe çdo shtet tjetër ka të njëjtin akses te *database-n* e Policisë së Shtetit, vetëm informacion imazhi jo alfanumerik.

Për ta bërë më të qartë këtë perceptim, sot ne këtë informacion e marrim nga Interpoli dhe procedura burokratike nga Inspektorati i Përgjithshëm i Interpolit në Interpol Tirana dhe anasjelltas, bëhet për tri javë më e shpejta dhe më e ngadalta për pesë javë, ndërsa me këtë marrëveshje, kjo do të bëhet për pesë minuta. Pra, sigurimi i informacionit bëhet në kohë reale. Për shembull, një person që është shpallur në kërkim ndërkombëtar apo një person që mund të ndalohet në një shtet tjetër, i cili mund të ketë dhënë identitet të rremë, duke e konsultuar me *database-n* tonë del që ky ka identitet tjetër në Shqipëri, në këtë rast fillon proceduara për fshehje identiteti. Në këtë pikëpamje kjo do t'i japë një zhdërvjelltësi të madhe punës së Policisë së Shtetit, si për gjurmët e gishtave, ashtu edhe për ADN-në dhe për të dhënat e automjeteve.

Ermonela Felaj – Kur fillon të vihet në zbatim?

Orest Afejzulli – Siç e tha edhe zëvendësministri, në radhë të parë duhet të sigurohet serveri TESTA, i cili është i kriptuar, në mënyrë që të mos ketë asnjë mundësi që person apo haker të futet në sistemet tona.

Kjo zgjidhje është bërë që në vitin 2004 në mbarë Europën, me marrëveshjen e “Prum-it” dhe është *copy-paste* me këtë mini Prum. Nga kjo pikëpamje të gjitha hallkat teknike juridike e të tjera janë të kopsitura. Në momentin që do të sigurohet ky sistem ne jemi gati, sepse kapacitetet tona i kemi të përmirësuara që në muajin dhjetor.

Siç e tha edhe zëvendësministri, mentor kemi Austrinë, të cilët erdhën dhe bënë një mision faktmbledhës dhe na dhanë detyrat për të bërë përmirësime, të cilat ne i kemi kryer. Pra, në momentin që TESTA do të bëhet efektive, puna fillon menjëherë. Unë besoj se kjo çështje do të zgjidhet përfundimisht brenda këtij viti.

Paulin Sterkaj – Meqenëse kjo marrëveshje është biseduar dhe është firmosur në vitin 2018, në projektbuxhetin e vitit 2019 parashikohet ndonjë gjë nga qeveria shqiptare? Apo do të rrimë gjithmonë duke shtrirë dorën për të kapur ndonjë gjë nga shtetet e tjera? Kështu nuk funksion, sepse shpeshherë nuk vijnë ato që i duhen sistemit.

A keni parashikuar diçka në projektbuxhetin e Ministrisë së Brendshme për ta realizuar këtë projekt?

Sa e ka koston kjo?

Ermonela Felaj – Besoj se është e qartë.

Duhet blerë serveri, që marrëveshja të bëhet funksionale në pikëpamjen praktike. Ka ndonjë llogari për këtë? E ka marrë përsipër këtë kosto qeveria? Brenda sa kohe mendon ajo ta realizojë këtë?

Besfort Lamallari – Zoti Sterkaj, faleminderit për pyetjet!

Në fakt, zbatimi praktik i marrëveshjes është çështja kryesore.

Shqipëria i ka marrë të gjitha masat për të siguruar që *database*-t të jenë në gjendjen e nevojshme teknike për të komunikuar me *database*-t e vendeve homologe, nënshkruese të kësaj marrëveshjeje. Kjo është arsyeja pse ne kërkuam edhe *mentorship*-in e Austrisë. Ata erdhën, vlerësuan dhe lanë detyra.

Komunikimi i vendeve anëtare, ndërfitja në sistemin TESTA, në pronësi të Komsionit European, po mendohet të bëhet *on block*, pra me të gjitha vendet, përmes skemave të financimit, për të cilat Komisioni European ka një program, por edhe gjetjes së donatorëve të ndryshëm. Pra, është një tentativë e dytë. Kjo është arsyeja pse u nënshkrua ky memorandum bashkëpunimi nga të gjithë ministrat.

Nga pikëpamja e buxhetit të shtetit, duke mos dashur të ishim arbitrarë në caktimin ose vetëcaktimin e Ministrisë së Brendshme si pikë hyrëse, fokale, me gjithë rëndësinë që ka dhe rolin primar në këtë marrëveshje, si dhe duke vlerësuar që sistemi TESTA i inkriptuar, më shumë se kësaj marrëveshjeje u shërben institucioneve të ndryshme shqiptare, doganave, tatimeve e të tjerë, ne, bashkë me AKSH-in, i thirrëm në një grup pune, i informuan për këtë zhvillim, që të ata të shprehnin interesin e tyre për sistemet aktuale, se si e ndajnë informacionin me agjencitë homologe të vendeve të tjera, për të pasur mundësinë e replikimit të këtyre në një kanal të vetëm komunikimi, që është sistemi TESTA.

Në momentin kur ne të kemi identifikuar të gjitha agjencitë, që kanë interes për shfrytëzimin e këtij kanali, do t'i kërkojmë edhe një herë Komsionit European, me të cilin jemi në kontakt të vazhdueshëm, shifrën vjetore që duhet të paguajmë.

Nga informacionet që kam, vitin e kaluar, në 2018-n, çdo vend anëtar, që e shfrytëzonte këtë kanal, duhet të paguante 13 mijë euro në muaj. Për vitin kur ne e kemi identifikuar këtë interes së bashku, shifra do të ndahet në mënyrë proporcionale me të gjitha agjencitë, që do të shprehin interes për ta shfrytëzuar këtë kanal komunikimi. Kjo është arsyeja pse ne, si Ministri e Brendshme, nuk u nxituam për ta... Megjithatë, përveç vendeve anëtare të BE-së, të cilat e kanë të implementuar këtë sistem, për shkak të marrëveshjes së PRYM-it, vendet e tjera joanëtare nuk janë në fazën e zbatimit. Edhe ato vende janë në të njëjtën gjendje, të sigurimit të donacioneve, të buxhetit e të tjera.

Besoj se jemi në rrugën dhe në ritmin e duhur.

Paulin Sterkaj – Domethënë, edhe Europa Juglindore do të shtrijë dorën për të marrë fonde për ta plotësuar këtë sistem? Këtë po na thoni?

Besfort Lamallari – Ka një program Komisioni European, që quhet ISA 2. Mali i Zi ka aplikuar, Serbia jo. Ka skema të ndryshme financimi, duke qenë se të dy sistemet, ai për të dhënat e automjeteve, Eucharius, si dhe sistemi TESTA, që shfrytëzohet për daktiloskopinë, profilet e ADN-së e të tjerë, kanë një *fee* të caktuar. E thashë, 13 mijë euro në muaj llogaritej në vitin 2018. Sigurisht, kjo ndryshon vit mbas viti.

Ka dy opsione: ose do të bëhet me donacione të huaja, si të gjitha vendet e tjera, ose me buxhetin e shtetit, duke e shpërndarë sipas agjencive të ndryshme që përfitojnë.

Ermonela Felaj – Pra, ju keni rënë dakord vetëm në parim, që të bëheni pjesë e kësaj marrëveshjeje, që lejon një kërkim në një bazë më të gjerë të dhënash, shumë herë më të madhe se ajo që disponon shteti shqiptar.

Në qoftë se nuk do të përmbusheshin kostot shtesë të financimit, sepse keni edhe sistemet, që lidhen me të dhënat daktiloskopike dhe të ADN-së, keni edhe sistemin që lidhet me të dhënat e automjeteve, ku kërkohet një kosto shtesë, çfarë ndodh me marrëveshjen në këtë rast? Në fund të ditës, a është menduar që mund të mos e bëjmë dot financimin? Po marr shkas nga fakti që ne kemi një sistem të ngjashëm, sistemi i vëzhgimit të integruar të hapësirës detare, që e shfrytëzojnë disa njësi qendrore, jo vetëm Ministria e Mbrotjes, dhe problemi i financimit të përbashkët në vetvete pengon që sistemi të azhurnohet, sepse jo të gjithë i përgjigjen kësaj nevojë. Si e keni diskutuar ju këtë gjë edhe me Ministrinë e Infrastrukturës? Nuk e di nëse ka qenë apo jo edhe kjo ministri bashkëfirmëtare në këtë marrëveshje, por është pjesë e kësaj

marrëveshjeje. E keni gjykuar këtë moment? Natyrisht, shtetit shqiptar, interesave të sigurisë, i vlen shumë një marrëveshje e tillë, pa asnjë diskutim, por mendoj se sa seriozë jemi kur marrim pjesë në marrëveshje të tilla, duhet të jemi edhe në diskutimin e të gjitha atyre hapave që sigurojnë që kostoja të mbulohet, që ky të mos ngelet një veprim thjesht formal.

Besfort Lamallari – Zonja kryetare, sigurisht që ne kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm me **Drejtorinë DJDG** të Komisionit European për mundësitë e ndryshme ose tarifave që duhet të paguajë çdo vend anëtar. Gjithsesi, nga ana jonë jemi kujdesur, së pari, që *database*-t të jenë në gjendje t'u përgjigjen në çdo moment, të ndërlidhen me këtë sistem. Kjo ishte arsyeja që ne pritëm dhe kërkuam mbështetjen e ekspertëve të Ministrisë së Brendshme austriake, të cilët erdhën, vlerësuan *database*-t, dhanë rekomandimet e tyre dhe me azhurnimet e fundit që janë bërë, nëse ka interes, mund të shprehet edhe përfaqësuesi i Institutit të Policisë Shkencore, kemi kërkuar të bëhet edhe një testim se sa mund të funksionojnë praktikisht në gjendjen që janë sot *database*-t, ku një gjurmë gishti e identifikuar, për shembull, në Serbi, të krahasohet në kohë reale me një gjurmë gishti në Institutin e Policisë Shkencore. Ky test është kërkuar dhe është bërë, por më tepër për këtë mund të flasë përfaqësuesi.

Ermonela Felaj – Besoj se zoti Afejzulli do të na sqarojë më tepër për këtë moment.

Orest Afejzulli – Nga pikëpamja e llogjistikës, sistemi AFIS i Policisë së Shtetit është i mbështetur financiarisht, si në mirëmbajtjen teknike, edhe me investimin që bëri qeveria shqiptare vitin që shkoi, të cilin e finalizuam në fund të dhjetorit, ku ndryshuam versionin e sistemit, nga versioni 7, u bë versioni 9, i cili është kompatibël me të gjitha mundësitë për ta shkëmbyer këtë informacion me të gjitha sistemet AFIS që janë instaluar sot në vendet e kësaj marrëveshjeje.

Njëkohësisht, brenda muajit që shkoi ne bëmë edhe *abdetimin* e formatit më të ri MIST, që është zemra e këtij shkëmbimi informacioni. Pra, nga pikëpamja financiare, sistemi ynë i gjurmëve të gishtave është i mbuluar dhe më shumë se kaq. Vjet qeveria na dha një fond shumë të madh, që ne e bëmë gati për hapin përfundimtar. Në këto momente ne jemi gati. Thjesht, siç tha edhe zëvendësministri, ne bëmë një testim virtual të dy sistemeve, të Shqipërisë dhe Serbisë, dhe realizohet praktikisht.

Mentori ynë, që është Austria, do të na asistojë dhe ka shprehur dëshirën që të bëjmë testimet e para direkt me ta. Nga kjo pikëpamje, ne teknikisht, të paktën për gjurmët e gishtave,

jemi në rregull, por presim sistemin TESTA, i cili është rrjeti i inkriptuar për të mos lënë asnjë akses mundësie për rrjedhje informacioni.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se është e njëjta gjë edhe në rast se do të pyesim për të dhënat e ADN-së. Aktualisht sot në Shqipëri i kemi të regjistruara të dhënat e ADN-së? Sa shkojnë si shifër?

Ela Zaimi – Përshëndetje!

Faleminderit, për pyetjen, zonja kryetare!

Aktualisht në Shqipëri ne kemi një bazë kombëtare të të dhënave të ADN-së, e instaluar në vitin 2015. Aktualisht gjenden rreth 2300 profile të ruajtura në *database*, që janë kryesisht profile të përfutuara nga ekzaminimi i provave materiale në vendngjarje, por referuar ligjit të ndryshuar nr. 108 “Për Policinë e Shtetit”, vjet në janar është bërë e mundur dhe ka filluar marrja e mostrës për të gjithë personat e ndaluar dhe të arrestuar në Shqipëri. Marrja e mostrës është procesi i parë, i cili do të shoqërohet nga analizat e ADN-së, të cilat përfundojnë me përfitim të profilit të ADN-së, që do të jetë pastaj edhe “ushqimi” i kësaj baze të dhënash ose rritja e kësaj baze kombëtare të dhënash, të cilat, sigurisht, do të jenë objekt i shkëmbimit dhe i reciprocitetit të kërkimeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Ky diskutim u zhvillua pak më shumë për sistemin AFIS, sepse ky sistem ka versione të ndryshme dhe në varësi të versioneve që ka është e mundur përshtatja ose shkëmbimi i të dhënave.

Lidhur me sistemin CODIS, ne kemi një version të gatshëm për lidhjen. CODIS është një bazë të dhënash, që e përdorin qoftë vendet e BE-së, qoftë vendet që u kanë shtuar sistemeve të tyre ruajtjen e *database*-ve. Versioni ynë është i ngjashëm me to dhe gati për t’u lidhur dhe për të shkëmbyer të dhëna në çdo kohë, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, qoftë edhe në një këndvështrim më të gjerë, në kuadër të aderimit tonë në Bashkimin Europian.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Të kesh prezent përfaqësues të Institutit të Policisë Shkencore është gjithnjë një rast i veçantë, sepse debati pastaj ngjall vërtet pyetje dhe mund të ishte edhe më i gjatë dhe të shkonte përtej qëllimit për të cilin jemi mbledhur.

Ky komision parlamentar ka vizituar, le të themi, të gjitha institucionet e sigurisë në vend, jo thjesht për të marrë kontakt me ju dhe për t’u njohur me punën tuaj, por edhe për t’u

njohur me shqetësimet e punës suaj të përditshme, që kanë nevojë t’u adresohen Ministrisë së Brendshme apo institucioneve të tjera përgjegjëse, me qëllim që ato të mund të fokusohen në problematikat e vërteta, por edhe fondet t’i orientojnë drejt plotësimit të këtyre problematikave. Ne jemi munduar ta bëjmë këtë gjë me shumë institucione, madje besoj se ka ardhur momenti që ne të jemi së shpejti tek Instituti i Policisë Shkencore për të folur më hollësisht për nevojat e punës suaj dhe për t’i ndarë pastaj këto nevoja edhe me Ministrinë e Brendshme.

Ftoj kolegët të kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes...” për të cilën diskutuam deri tani. Kush është dakord në parim me projektligjin?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nën për nën të marrëveshjes në fjalë.

Si çdo marrëveshje, në fakt, edhe kjo ka vetëm dy nene, që kanë të bëjnë me ratifikimin e marrëveshjes dhe me hyrjen në fuqi të saj.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin, të cilin do të duhet ta citoj fjalë për fjalë: “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Me miratimin e kësaj marrëveshjeje dua të falënderoj të gjithë përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe të Institutit të Policisë Shkencore dhe t’u uroj punë të mbarë! Bashkë do të shihemi te vendi juaj i punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Falënderoj edhe kolegët për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA